

L I G J
Nr.9072, datë 22.5.2003

PËR SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

(Ndryshuar me ligjin nr. 9512, datë 10.4.2006; nr. 9626, datë 16.10.2006; nr. 9750, datë 4.6.2007; nr. 9776, datë 12.7.2007; nr. 9913, datë 5.5.2008; nr. 9997, datë 22.9.2008; nr. 10 137, datë 11.5.2009; nr. 10 196, datë 10.12.2009; nr. 10 362, datë 16.12.2010; nr. 10 485, datë 26.11.2011)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është sigurimi i kushteve për furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve, sipas parametrave standarde. Kjo sigurohet nëpërmjet funksionimit eficient të tregut të energjisë elektrike dhe zhvillimit të konkurrencës në këtë sektor, duke pasur parasysh mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, minimizimin e kostove të shërbimit me energji elektrike dhe përshtatshmërinë e tij me mjedisin.

Neni 2
Objekti

1. Ky ligj rregullon veprimtaritë në sektorin e energjisë elektrike, përcakton të drejtat dhe detyrat e personave fizikë dhe juridikë, të administratës publike të përfshirë në këtë sektor, si dhe procedurat për përzgjedhjen dhe zhvillimin e një modeli tregu dhe të rregullave të funksionimit të tij.

Ky ligj përcakton:

- a) autoritetin institucional të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike, që më poshtë do të quhet ERE;
- b) ristrukturimin, komercializimin dhe privatizimin përfundimtar të KESH-it dhe zhvillimin e një tregu konkurrues të energjisë elektrike;
- c) nxitjen e tregtisë rajonale të energjisë elektrike;
- ç) investime në sektorin e energjisë elektrike.

Neni 3
Përkufizime

(Ndryshuar pikat 22, 23,30 dhe 33, shtuar pika 30/1 me ligjin nr. 9512, datë 10.4.2006; shtuar pika 35/1 me ligjin nr. 9626, datë 16.10.2006¹; shtuar pika 21/1 me ligjin

¹ Pas pikës 35 të nenit 2 shtohet pika 35/1 me ligjin nr. 9626, datë 16.10.2006, por duhet shtuar në nenin 3.

nr. 9776, datë 12.7.2007; ndryshuar pika 15, 25, 26, 29, 30, 38, ndryshuar fjalë në pikën 31/1, shtuar pika 30/2 me ligjin nr. 9913, datë 5.5.2008; shtuar pikat 39/1 dhe 39/2 me ligjin nr. 10 196, datë 10.12.2009; ndryshuar pika 35/1 me ligjin nr. 10 362, datë 16.12.2010)

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. “Ministër përgjegjës për energjinë” është Ministri i Industrisë dhe Energjetikës ose ministri përgjegjës për energjinë.
2. “KESH” është Korporata Elektroenergjetike Shqiptare.
3. “Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike” është institucioni rregullator i sektorit të energjisë elektrike që vepron sipas këtij ligji.
4. “Bordi i Komisionerëve” ose “Bordi” është organi vendimmarrës i ERE-së, i përbërë nga pesë anëtarë të emëruar, sipas procedurave të parashikuara në këtë ligj.
5. “Anëtar” është një anëtar i Bordit të ERE-së, i emëruar ose që shërben në përputhje me këtë ligj, përfshirë Kryetarin e ERE-së, me përjashtim të rasteve kur ky ligj parashikon ndryshe.
6. “Kryetari” është Kryetari i ERE-së i emëruar ose që shërben sipas këtij ligji.
7. “Person” është një person fizik ose juridik.
8. “Licencë” është autorizimi që i jepet një personi, sipas përcaktimeve në Pjesën e Tretë të këtij ligji.
9. “I licencuar” është një person që ka licencën, sipas përcaktimeve në Pjesën e Tretë të këtij ligji.
10. “Pagesa e licencës” është pagesa e vendosur nga ERE-ja për çdo licencë të dhënë, për të kryer një veprimtari në sektorin e energjisë elektrike.
11. “Pagesa të rregullimit” janë pagesat vjetore të vendosura nga ERE-ja për veprimtaritë e licencuara, që janë objekt i rregullimit.
12. “Sistemi elektroenergjetik” është një sistem i ndërlidhur, i përbërë nga centralet e prodhimit të energjisë elektrike, linjat, nënstacionet dhe pajisjet shpërndarëse, për transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike te konsumatorët.
13. “Prodhim i energjisë elektrike” është prodhimi i energjisë elektrike nëpërmjet transformimit të burimeve të ndryshme energjetike nga një shoqëri prodhimi.
14. “Shoqëri prodhuese” është një person i licencuar për të kryer veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
15. “Prodhues i pavarur i energjisë elektrike” është prodhuesi jopublik, i lidhur drejtpërdrejt në sistemin e transmetimit.
16. “Prodhues i privilegjuar” është prodhuesi që përmbush kriteret e parashikuara në nenin 39 dhe që përfiton një status të privilegjuar.
17. “Vetëprodhues” është personi që prodhon energji elektrike, kryesisht për përdorim vetjak.
18. “Burim zëvendësues” është një burim i dytë i furnizimit me energji elektrike, i palidhur me sistemin elektroenergjetik.
19. “Bashkëprodhim” është prodhimi i kombinuar i energjive të dobishme elektrike dhe termike, i cili siguron një kursim të konsiderueshëm të energjisë, krahasuar me prodhimin e ndarë.
20. “Transmetim” është transporti i energjisë elektrike në sistemin e tensionit të lartë, funksioni i të cilit përfshin transmetimin ose interkonjeksionin ndërkombëtar.
21. “Sistem transmetimi” është sistem linjash, strukturash mbështetëse dhe pajisjesh transformuese e kontrolluese, të përdorura për transmetimin e energjisë elektrike.
- 21/1 “Linjat tregtare të interkonjeksionit” janë linjat e reja elektrike të interkonjeksionit, me rrymë të vazhduar, ndërmjet dy sistemeve kombëtare elektrike, si dhe të nënstacioneve të invertimit, të ndërtuara me nismën dhe kapitalin e palëve të treta.

Në raste të veçanta, linja tregtare të interkonjeksionit janë dhe linjat e reja të interkonjeksionit, me rrymë alternative, kur kostoja dhe risku i investimit janë shumë të lartë në krahasim me koston dhe riskun, që investitori merr përsipër në ndërtimin e linjave të interkonjeksionit, me rrymë alternative, ndërmjet dy sistemeve fqinje

22. “Shoqëri transmetimi” ose “Operatori i sistemit të transmetimit” është personi i licencuar për të kryer veprimtaritë e transmetimit të energjisë elektrike, dispeçerimit të sistemit elektroenergjetik, si dhe për operimin e tregut të energjisë elektrike.

23. “Dispeçerim” është operimi i sistemit elektroenergjetik, në mënyrë që të ruhen balancat ndërmjet prodhimit, import/eksportit dhe konsumit të energjisë elektrike në nivel kombëtar, duke ruajtur sigurinë dhe qëndrueshmërinë e sistemit.

24. “Kodi i Funksionimit të Rrjetit” është tërësia e rregullave teknike që rregullojnë funksionimin e sistemit të transmetimit.

25. “Shpërndarja” është transporti i energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes me tension të lartë (nënstacionet 110 kV), të mesëm dhe të ulët, deri te klienti i fundit, por që nuk përfshin furnizimin.

26. “Operator i Sistemit të Shpërndarjes” është personi përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes.

27. “Kodi i Funksionimit të Shpërndarjes” është tërësia e rregullave teknike, që rregullojnë funksionimin e rrjetit të shpërndarjes dhe që vendosin kushtet dhe termat e shërbimit të shoqërive të shpërndarjes për konsumatorët.

28. “Parametra standardë” janë vlerat e nivelit të tensionit dhe të frekuencës së energjisë elektrike të furnizuar për konsumatorët, të përcaktuara në rregulloret e shfrytëzimit të sistemit elektroenergjetik të miratuara nga ERE-ja.

29. “Hyrja e palëve të treta” është e drejta e të gjithë prodhuesve, tregtuesve, furnizuesve dhe përdoruesve të energjisë elektrike, për të përdorur rrjetet e transmetimit e të shpërndarjes së energjisë elektrike, sipas rregullave dhe tarifave të përcaktuara në aktet e tjera ligjore e nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë e sektorit të energjisë elektrike.

30. “Furnizim” është shitja dhe blerja për rishitje te klientët e energjisë elektrike.

30/1. “Furnizuesi publik me pakicë” është personi i licencuar për të furnizuar klientët tariforë.

30/2. “Furnizuesi publik me shumicë” është personi i licencuar për blerjen e energjisë elektrike nga gjenerimi publik, nga PPE-të, PVE-të apo tregtuesit për shitjen te furnizuesi publik me pakicë.

31. “Furnizues i kualifikuar” është personi i licencuar për të furnizuar një ose më shumë klientë të kualifikuar.

32. “Klient i kualifikuar” është klienti që ka të drejtë të zgjedhë, për nevojat e tij vetjake, furnizuesin e energjisë elektrike.

33. “Klienti tarifor” është klienti, që furnizohet nga furnizuesi publik me çmime dhe tarifa të rregulluara.

34. “Klient i fundit” është klienti që blen energji elektrike për përdorim vetjak.

35. “Treg i energjisë elektrike” është shkëmbimi i kërkesave dhe ofertave për blerje dhe shitje ose furnizim të energjisë elektrike.

35/1. Shkëmbimi, shitja dhe blerja e energjisë elektrike, në kuptim të këtij ligji, është marrëdhënia juridike ndërmjet palëve, sipas dispozitave përkatëse të Kodit Civil.

36. “Rregullat e tregut” janë rregullat e veprimit dhe menaxhimit të tregut, si dhe të marrëdhënieve tregtare ndërmjet mbajtësve të licencës.

37. “Linjë e drejtpërdrejtë” është linja e energjisë elektrike, që nuk është e lidhur me rrjetin elektroenergjetik, që lidh prodhimin me një klient të fundit.

38. “Prodhues i vogël i energjisë elektrike” është një prodhues me kapacitet të instaluar, që është i lidhur drejtpërdrejt në sistemin e shpërndarjes.

39. “Burime të energjive të rinovueshme” janë burimet e energjisë, të cilat gjenden në natyrë dhe janë të rinovueshme, si ajo diellore, e erës, hidrike, gjeotermale, e biomasës ose biogazit, si dhe energjia nga mbetjet urbane.

39/1. “Certifikata e gjelbër” është dokumenti zyrtar me kohë vlefshmërie të kufizuar, e transferueshme veçmas fizikisht nga energjia elektrike, të cilën e certifikon. Ajo vërteton prodhimin e një sasive të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme të energjisë apo nga një metodë e kombinuar prodhimi, në të cilën jepen data dhe vendi i prodhimit, centrali gjenerues dhe pronari.

39/2. “Certifikata e garancisë së origjinës” është një dokument zyrtar i transferueshëm, që vërteton prodhuesin, sasinë e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e energjive të rinovueshme, centralin elektrik dhe kapacitetin e tij.

40. “Forcë madhore” është një ngjarje ose një akt natyror ose shoqëror që ndodh në vend, si tërmetet, ciklonet, rrufetë, përmbytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret, lufta, konfliktet e armatosura, kryengritjet, aktet terroriste, të cilat pengojnë të licencuarin të përmbushë detyrimet e tij sipas licencës, si dhe akte ose ngjarje të tjera, të cilat janë jashtë kontrollit të mundshëm të të licencuarit dhe nuk ndodhin për faj të tij dhe i licencuari nuk është në gjendje t’i eliminojë ato, edhe pse ka ushtruar siç duhet aftësitë, përpjekjet dhe kujdesin e tij.

PJESA E DYTË STRUKTURA DHE ORGANIZIMI I ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Neni 4

(Ndryshuar pikat 4 dhe 7 me ligjin nr. 9512, datë 10.4.2006)

1. ERE-ja është person juridik, publik me seli në Tiranë.
2. ERE-ja përbëhet nga Bordi i Komisionerëve dhe personeli teknik.
3. Bordi përbëhet nga Kryetari dhe katër anëtarë, që emërohen nga Kuvendi, me propozimin e Ekipit Përzgjedhës, sipas pikës 5 të këtij neni.
4. Ekipi përzgjedhës përbëhet nga dy përfaqësues të Kuvendit, përkatësisht nga Kryetari i Komisionit të Përhershëm për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin dhe Kryetari i Komisionit të Përhershëm për Ekonominë dhe Financat, si dhe ministri përgjegjës për energjinë. Ekipi përzgjedhës merr vendim me shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve të tij.
5. Ekipi Përzgjedhës:
 - a) mblidhet kur është e nevojshme ose jo më vonë se gjashtë muaj para përfundimit të mandatit të një anëtari të Bordit;
 - b) propozon dy kandidatë, për çdo vend vakant në Bord, që kanë aftësinë dhe përvojën, siç përcaktohet në pikën 7 të këtij neni.
6. Kur posti i Kryetarit të Bordit mbetet vakant, detyrat e tij i kryen anëtari më i vjetër i Bordit, deri në emërimin e kryetarit të ri. Vjetërsia e tij llogaritet nga data kur është emëruar anëtar i Bordit.
7. Kryetari dhe anëtarët e bordit duhet të jenë persona me arsim të lartë dhe me përvojë:
 - a) Kryetari të jetë një person i shquar në fushën e elektroenergjetikës. Ai duhet të ketë jo më pak se 15 vjet përvojë pune, prej të cilave jo më pak se 10 vjet në sektorin e energjisë elektrike;
 - b) njëri nga anëtarët duhet të ketë jo më pak se 10 vjet përvojë pune si inxhinier elektrik në sektorin elektroenergjetik;
 - c) dy nga anëtarët duhet të jenë ekonomistë dhe të kenë jo më pak se 7 vjet përvojë pune në këtë profesion;
 - ç) njëri nga anëtarët duhet të jetë jurist dhe të ketë jo më pak se 7 vjet përvojë pune në

këtë profesion.

8. Anëtarësia në Bordin e ERE-së do të jetë për një periudhë pesëvjeçare, përveç ERE-së së parë të emëruar sipas këtij ligji, e cila do t'i nënshtrohet rinovimit të pjesshëm nëpërmjet hedhjes me short. Dy prej anëtarëve zëvendësohen pas katër vjetësh qëndrimi në detyrë dhe dy të tjerët zëvendësohen pas tre vjetësh. Kryetari zëvendësohet pas pesë vjetësh. Shorti organizohet nga Kryetari në prezencën e të gjithë anëtarëve, sipas një rregulloreje të miratuar më parë.

9. Kur anëtari emërohet në një vend vakant, të krijuar para përfundimit të afatit kohor, për të cilin ishte emëruar paraardhësi, ai qëndron në detyrë vetëm për periudhën e mbetur të këtij mandati.

10. Anëtari i ERE-së emërohet në Bord për një mandat pesëvjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

11. Kuvendi cakton pagën e Kryetarit dhe të anëtarëve të Bordit.

Neni 5

Lirimi nga detyra i anëtarëve të Bordit të ERE-së

(Shtuar shkronja "dh" me ligjin nr. 9512, datë 10.4.2006)

Anëtari i Bordit lirohet nga detyra vetëm në rastet kur:

a) i është kufizuar ose hequr zotësia për të vepruar me vendim gjyqësor të formës së prerë;

b) është i paaftë për të përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë e ERE-së për një periudhë mbi gjashtë muaj;

c) vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji;

ç) bëhet ose kandidon për deputet, bëhet nëpunës në administratën shtetërore ose në ndonjë autoritet vendor;

d) dënohet për kryerjen e një vepre penale, me vendim gjyqësor të formës së prerë;

dh) kur nuk plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 4 të ligjit.

Neni 6

Konfliktet e interesave

1. Anëtari i Bordit ose i personelit teknik nuk mund të jetë:

pronar, aksioner i aseteve në pronësi të ndonjë të licencuari;

b) punonjës ose kontraktues i ndonjë të licencuari;

c) anëtar i bordeve ose bordeve mbikëqyrëse ose i organizmave të tjerë drejtues të ndonjë të licencuari;

ç) drejtor, president ose menaxher i ndonjë të licencuari, si dhe nuk lejohet të ketë interes material ose interes tjetër në fushën e energjisë.

2. Kur anëtari i Bordit ose i personelit teknik gjendet në konflikt interesi gjatë procedurave të aplikimit për licencë, ai nuk merr pjesë në shqyrtimin e aplikimit.

3. Anëtari i Bordit ose i personelit teknik mund të jetë klient i ndonjë të licencuari, por i licencuari nuk i ofron dhe anëtari i Bordit ose i personelit teknik nuk duhet të pranojë shërbim më të favorshëm ose të ndryshëm nga pikëpamja e tarifave dhe kushteve që zbatohen për publikun.

4. Për një periudhë njëvjeçare pas largimit nga detyra, anëtari i Bordit nuk ka të drejtë të punësohet ose të kompensohet në ndonjë mënyrë nga ndonjë shoqëri që ka qenë ose ka aplikuar për licencë, gjatë kohës që ai ka qenë anëtar i Bordit, pa miratimin paraprak të Këshillit të Ministrave.

Neni 7
Kryetari i ERE-së

1. Kryetari i ERE-së është administratori ekzekutiv i ERE-së dhe është përgjegjës për administrimin e ERE-së, për drejtimin e mbledhjeve të Bordit dhe për publikimin e vendimeve të tij.

2. Në mungesë të tij, Kryetari cakton njërin nga anëtarët e Bordit për të ushtruar të drejtat dhe detyrat e tij.

Neni 8
Përgjegjësitë e ERE-së

(Shtuar shkronja "l" me ligjin nr. 9626, datë 16.10.2006; ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 9913, datë 5.5.2008; shtuar shkronjat "ll", "m" e "n" me ligjin nr. 10 196, datë 10.12.2009; ndryshuar shkronja "l" e pikës 2 me ligjin nr. 10 362, datë 16.12.2010)

1. ERE-ja e ushtron veprimtarinë e vet në përputhje me këtë ligj.
2. ERE-ja ka përgjegjësitë e mëposhtme:
 - a) përcakton rregullat dhe kërkesat për dhënien, ndryshimin, transferimin dhe heqjen e licencave të shoqërive për prodhimin, transmetimin, shpërndarjen, furnizimin dhe tregtimin e energjisë elektrike;
 - b) përcakton dhe rregullon tarifat e shitjes me shumicë dhe me pakicë, afatet dhe kushtet e shërbimit të energjisë elektrike, të propozuara nga i licencuari ose i rishikon ato në përputhje me rrethanat;
 - c) garanton që programet e investimeve dhe kontratat e blerjeve të energjisë elektrike të jenë në përputhje me parimet e planifikimit me koston më të ulët;
 - ç) mbron interesat e konsumatorëve të energjisë elektrike për tarifat, duke garantuar që:
 - i) këto tarifa janë në përputhje me parimet e vendosjes së tarifave;
 - ii) kushtet e tjera të shërbimeve, si cilësia, efikasiteti, qëndrueshmëria dhe siguria e furnizimit me energji elektrike janë të përshtatshme, sipas rrethanave;
 - d) zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet të licencuarve dhe konsumatorëve dhe ndërmjet të licencuarve sikurse përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore;
 - dh) ruan ekuilibrin ndërmjet interesave të konsumatorëve, shtetit, investitorëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në sektorin e energjisë elektrike;
 - e) nxit efikasitetin e energjisë elektrike dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit në sektorin e energjisë elektrike;
 - ë) nxit konkurrencën në sektorin e energjisë elektrike;
 - f) monitoron dhe kontrollon kontratat dhe shërbimet e të licencuarit, në mbështetje të autoritetit që gëzon për inspektimet, marrjen e dokumentacionit dhe të të dhënave;
 - g) kontrollon nëse i licencuari, që ofron shërbimin me energji elektrike për konsumatorët, respekton kushtet e kontratës ose siguron shërbime, sipas standardeve të vendosura në licencë ose në ndonjë rregullore të miratuar nga ERE-ja;
 - gj) bashkëpunon me autoritetet simotra të vendeve të tjera ose organizatat ndërkombëtare dhe merr pjesë në veprimtaritë që organizojnë ato;
 - h) boton dhe bën të njohura kushtet në të cilat sigurohen shërbimet e energjisë elektrike për një transparencë maksimale, për nxitjen e konkurrencës në furnizim;
 - i) miraton Kodin e Funksionimit të Rrjetit të Transmetimit, Kodin e Funksionimit të Shpërndarjes, si dhe kodet e tjera që rregullojnë veprimtarinë e të licencuarve dhe marrëdhëniet e tyre me klientët;
 - j) miraton për të licencuarit rregulloren teknike të punës për prodhimin, transmetimin

dhe shpërndarjen e energjisë elektrike;

k) miraton rregullat e praktikës dhe procedurave që do të përdoren për funksionimin e ERE-së, sipas këtij ligji;

l) miraton rregullat dhe procedurat, sipas të cilave bëhen shkëmbimi, blerja dhe shitja e energjisë elektrike nga dhe te furnizuesit/tregtarët vendas dhe të huaj;

ll) kualifikon centralet prodhuese të ushqyera nga burime të rinovueshme të energjisë, si dhe certifikon energjinë e prodhuar prej tyre me “Certifikatën e garancisë së origjinës” dhe “Certifikatën e gjelbër”, çka do të shërbejë për plotësimin e detyrimit të shprehur në pikën 1 të nenit 3 të këtij ligji;

m) harton dhe miraton rregulla dhe procedura të veçanta për kualifikimin e centraleve prodhuese, që përdorin burime të rinovueshme të energjisë, si dhe për certifikimin e energjisë së prodhuar prej tyre me “Certifikatën e garancisë së origjinës” dhe “Certifikatën e gjelbër”, ku përcaktohen:

i) kategoritë e centraleve dhe afatet e vënies së tyre në punë, për përfitimin e certifikatave të origjinës dhe certifikatave të gjelbra;

ii) formula dhe koeficientet llogaritës të sasisë se energjisë elektrike të prodhuar, që përfiton “Certifikatën e garancisë së origjinës” dhe “Certifikatën e gjelbër”, në funksion të kapacitetit të instaluar dhe të teknologjisë së përdorur;

iii) vlera nominale e certifikatave, e shprehur në MWh;

iv) elemente të tjera të nevojshme për përshtatjen e procesit të kualifikimit dhe të certifikimit të energjisë së rinovueshme me atë të vendeve, me të cilat nënshkruhen marrëveshje për njohjen e ndërsjellë të procedurave të kualifikimit dhe të certifikimit;

n) harton dhe miraton formatin e “Certifikatës së gjelbër” dhe të “Certifikatës së garancisë së origjinës”.

Neni 9

Mbledhjet dhe vendimet e Bordit të ERE-së

1. Mbledhjet vendimmarrëse dhe seancat e dëgjimit të Bordit të ERE-së janë të hapura. Në raste të veçanta, Bordi mund të zhvillojë edhe mbledhje të mbyllura.

2. Numri i anëtarëve për të arritur shumicën e nevojshme në një mbledhje vendimmarrëse të Bordit është jo më pak se tre anëtarë. Bordi merr vendime me shumicën e të gjithë anëtarëve të tij. Çdo anëtar, përfshirë edhe Kryetarin, ka të drejtën e një vote. Në rast se numri i votave është i barabartë, vota e Kryetarit është përcaktuese.

3. Bordi i merr të gjitha vendimet në mënyrë të pavarur.

4. Kundër vendimit të Bordit të ERE-së mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga botimi i vendimit në Fletoren Zyrtare. Gjykata gjykon vetëm mbi ligjshmërinë ose themelësinë e vendimit të Bordit dhe mund të vendosë anulimin pjesërisht ose tërësisht të vendimit, kur nuk e gjen të bazuar në ligj.

5. Në rast anulimi, Bordi rishikon vendimin e tij ose ankimon vendimin e gjykatës, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile.

6. Vendimet e Bordit, përveç atyre që kanë të bëjnë me çështje të brendshme të ERE-së, botohen në Fletoren Zyrtare.

Neni 10

Raportimi

1. ERE-ja i paraqet Kuvendit të Shqipërisë, jo më vonë se fundi i tremujorit të parë të çdo viti, një raport vjetor për gjendjen e sektorit të energjisë elektrike, të veprimtarive të ERE-së, përfshirë edhe veprimtaritë financiare. Raporti bëhet publik.

2. Auditimi i veprimtarive fiskale të ERE-së kryhet nga auditues financiarë të pavarur, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Me kërkesën e ministrit përgjegjës për energjinë, ERE-ja jep të dhëna, në përputhje me funksionin dhe ekspertizën e saj.

Neni 11

Personeli teknik dhe këshilltarët

1. Në kryerjen e detyrave të tij, Bordi ndihmohet nga një personel teknik, i cili përzgjidhet, emërohet dhe promovohet në detyrë, sipas kriterëve dhe procedurave të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.

2. Bordi ka përgjegjësi të përcaktojë organizimin, detyrat dhe pagat e personelit teknik, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Përveç personelit teknik, Bordi, kur është e nevojshme, punëson specialistë ose këshilltarë për të ndihmuar ERE-në në kryerjen e detyrave të saj.

Neni 12

Financimi

1. Burimet e financimit të ERE-së përbëhen nga pagesat e rregullimit, të vendosura nga ajo vetë për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike, dhe nga pagesat e licencave.

2. ERE-ja mban llogari të plota dhe të sakta të shpenzimeve faktike, në përputhje me legjislacionin shqiptar të kontabilitetit.

3. ERE-ja përcakton për çdo të licencuar një pagesë rregullimi.

4. ERE-ja, pasi përcakton pagesat e rregullimit, njofton të licencuarin për shumën e detyrimit që duhet paguar. Në rast se i licencuari nuk arrin të paguajë këtë shumë brenda 30 ditëve nga marrja e këtij njoftimi, ndaj tij zbatohen sanksione në përputhje me nenin 64 të këtij ligji.

5. Pagesat e rregullimit depozitohen në një llogari të veçantë për përdorim nga ERE-ja, të hapur në një nga bankat e licencuara, sipas legjislacionit shqiptar. Çdo fond në llogarinë e ERE-së, që nuk është përdorur gjatë një viti kalendarik, bartet në vitin pasardhës, duke reduktuar proporcionalisht pagesat e rregullimit të vitit pasardhës.

6. ERE-ja ka të drejtë të marrë hua për rastet kur shpenzimet kapitale ose operative nuk mbulohen nga pagesat e mbledhura të rregullimit. ERE-ja shlyen huatë, përfshirë dhe interesin, nga pagesat e ardhshme të rregullimit.

PJESA E TRETË

LICENCAT DHE PROCEDURAT E LICENCIMIT

Neni 13

Veprimtaritë e licencuara dhe përjashtimet

(Shtuar pika 8 me ligjin nr. 9512, datë 10.4.2006; ndryshuar shkronja “a”, “ç” dhe “d”, shfuqizuar shkronja “dh” e pikës 1, ndryshuar pika 3 dhe 7, shfuqizuar pika 5 me ligjin nr. 9913, datë 5.5.2008)

1. ERE-ja lëshon licencë për veprimtaritë e mëposhtme:

- a) prodhimin e energjisë elektrike;;
- b) transmetimin e energjisë elektrike;
- c) shpërndarjen e energjisë elektrike;
- ç) furnizimin me shumicë ose me pakicë të energjisë elektrike;

- d) tregtimin e energjisë elektrike, brenda dhe jashtë vendit;
- dh) shfuqizuar.

Forma, mënyra dhe pagesa e aplikimit përcaktohen nga ERE-ja.

2. ERE-ja i jep licencë për transmetimin e energjisë elektrike vetëm një personi juridik shtetëror.

3. ERE-ja i jep licencë për shpërndarjen e energjisë elektrike vetëm një personi juridik.

4. Personi që kryen veprimtari të ndryshme, të cilat janë objekt licencimi, merr licenca të veçanta për to. ERE-ja është e detyruar të shmangë çdo mospërputhje në kushtet e licencave të lëshuara, për të njëjtin person, për veprimtari të ndryshme.

5. Shfuqizuar.

6. Për një linjë të drejtpërdrejtë nuk kërkohet licencë transmetimi ose shpërndarjeje.

7. Për vetëprodhuesin, që nuk është i lidhur me sistemin elektroenergjetik, nuk është i nevojshëm licencimi me licencë prodhimi.

8. Çdo person që kërkon të ushtrojë veprimtarinë në këtë fushë duhet të licencohet, sipas këtij ligji, nga ERE-ja.

Neni 14

Procedurat e licencimit

(Ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 9913, datë 5.5.2008)

1. Licencat jepen nga ERE-ja, sipas procedurave që sigurojnë trajtim të barabartë, jodiskriminues dhe me transparencë gjatë procesit të licencimit. Këto procedura ndiqen sipas kërkesës për çdo tip aplikimi për licencë.

2. ERE-ja miraton rregulloren për procedurat e licencimit, në përputhje me këtë ligj, ku përcaktohen kriteret dhe kushtet për dhënien, ndryshimin, transferimin ose heqjen e licencës, si dhe pagesa, që duhet kryer për çdo tip aplikimi për licencë. ERE-ja miraton rregulloren për vendosjen e procedurave të thjeshta dhe të përshejtuara për licencimin e centraleve elektrike, të lidhura drejtpërdrejt në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

Neni 15

Kushtet e licencës

1. ERE-ja përcakton kushtet e çdo license, duke marrë parasysh:

- a) afatet e kërkuara për vlefshmërinë e licencës;
- b) vendndodhjet dhe territoret në të cilat do të kryhen veprimtaritë e licencuara të energjisë elektrike;
- c) funksionimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të impianteve, të pajisjeve ose të rrjetit;
- ç) kërkesat për llojin e burimeve parësore të energjisë;
- d) kërkesat lidhur me sigurinë kombëtare, jetën e qytetarëve, pasurinë, shëndetin dhe rendin publik;
- dh) kërkesat financiare;
- e) mbrojtjen e mjedisit;
- ë) nxitjen e efikasitetit të energjisë në sektorin e energjisë elektrike;
- f) detyrimet e shërbimit publik, siç parashikohet në këtë ligj;
- g) nxitjen e një tregu kompetitiv të energjisë elektrike dhe parimet e kostos më të ulët në furnizimin me energji elektrike;
- gj) efektin ndaj sigurisë dhe qëndrueshmërisë së furnizimit me energji elektrike, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. ERE-ja mund të kërkojë prova, të dhëna dhe dokumente, që i nevojiten për të verifikuar kualifikimet dhe kompetencat e aplikuesit për licencë.

3. ERE-ja mund t'ia refuzojë dhënien e licencës një aplikuesi kur ky nuk përmbush njërin nga kushtet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni. Kur ERE-ja arrin në përfundimin se ndonjë nga kushtet e paplotësuara nuk është thelbësore dhe mund të plotësohet, ajo mund t'ia japë licencën, me kusht që i licencuari të përmbushë kushtet e paplotësuara brenda një afati kohor të përcaktuar nga ERE-ja.

Neni 16

Njoftimi i aplikimeve dhe vërejtjeve për licencën (Shfuqizuar fjalia e fundit e pikës 1 me ligjin nr. 9913, datë 5.5.2008)

1. Për çdo aplikim për licencë, sipas këtij neni, ERE-ja boton, brenda 14 ditëve pasi është bërë aplikimi, njoftimin e kërkesës për licencë, sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren për procedurat e licencimit.

2. Licenca jepet pasi shqyrtohen të gjitha vërejtjet ose ankesat për këtë kërkesë. ERE-ja nuk merr parasysh vërejtjet ose ankesat e bëra pas dy muajve nga data e botimit të parë të njoftimit.

3. Kur një autoritet vendor i interesuar dërgon një vërejtje ose ankesë dhe ERE-ja i vlerëson këto të pabazuara, ajo njofton autoritetin vendor me shkrim, duke dhënë arsyet për këtë vendim.

Neni 17

Refuzimi i licencës

1. ERE-ja mund të refuzojë dhënien e licencës kur konstaton rrezik për jetën e njerëzve, shëndetin, mjedisin, pasurinë e personave të tretë dhe interesat e konsumatorëve ose dëmtimin e furnizimit të qëndrueshëm me energji elektrike.

2. Nuk i jepet licencë një personi:

a) i cili është në pamundësi të pagimit të debive ose të likuidimit, sipas legjislacionit për falimentimin;

b) licenca e të cilit është anuluar ose hequr dhe periudha e përcaktuar në vendimin e ERE-së për heqjen nuk ka përfunduar.

3. Në rast refuzimi, aplikuesi mund të paraqesë një aplikim të ri për licencë për të njëjtën veprimtari, por jo më parë se gjashtë muaj pas datës efektive të vendimit të ERE-së, që refuzon dhënien e licencës mbi bazën e aplikimit të mëparshëm.

Neni 18

Heqja e licencës

(Shtuar shkronja “e” në pikën 1 me ligjin nr. 9913, datë 5.5.2008; shtuar shkronja “ë” në pikën 1 me ligjin nr. 10 485, datë 26.11.2011)

1. ERE-ja mund ta heqë licencën kur i licencuari:

a) nuk përmbush kushtet e licencës së dhënë sipas këtij ligji;

b) gjatë kryerjes së veprimtarisë në sektorin e tij, shkel dispozitat ligjore për mbrojtjen e mjedisit;

c) rrezikon shëndetin, jetën dhe pronën e njerëzve;

ç) nuk arrin të shlyejë pagesat e rregullimit të përcaktuara nga ERE-ja, sipas nenit 12;

d) nuk e ka nisur veprimtarinë e licencuar brenda kohës së përcaktuar në licencë;

dh) nuk arrin të përmbushë kushtet e licencës për shkaqe financiare;

e) me kërkesën e të licencuarit;

ë) për shkelje të përsëritura nga i licencuari.

2. Në rast se ERE-ja mendon se heqja e licencës mund të ndikojë në interesin publik, vepron sipas nenit 64 të këtij ligji.

3. ERE-ja miraton rregulloren, ku përcaktohen procedurat e heqjes së një licence. Këto procedura kërkojnë që ERE-ja:

a) të njoftojë me shkrim të licencuarin, se ka propozuar heqjen e licencës të paktën 60 ditë para se heqja të bëhet e detyrueshme, duke argumentuar arsyet për këtë heqje;

b) t'i japë mundësi të licencuarit të përgjigjet me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit;

c) kur është në interesin e përgjithshëm, mund t'i japë të licencuarit 30 ditë afat, pas përgjigjes me shkrim, që të veprojë në përputhje me licencën, në mënyrë që të mënjanojë shkaqet për të cilat është propozuar heqja e licencës.

4. Kur ERE-ja heq një licencë, duhet të zbatojë njërin nga kushtet e përkohshme, të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni, në mënyrë që pajisjet dhe asetet, në pronësi të të licencuarit, të mund të vazhdojnë të funksionojnë në sigurimin e shërbimit të energjisë elektrike për klientët:

a) ta lejojë të licencuarin të vazhdojë t'i përdorë këto pajisje dhe asete, sipas kushteve dhe afateve të caktuara;

b) të kontraktojë me një ose me më shumë shoqëri private, që mund të ndërmarrin vazhdimin e këtij shërbimi;

c) të emërojë një administrator, që të mbikëqyrë ose të operojë pajisjet dhe pasuritë, sipas licencës.

5. Kushtet e përkohshme vendosen derisa licenca t'i jepet një personi tjetër, që do të vazhdojë këtë veprimtari.

Kur hiqet një licencë, Këshilli i Ministrave vendos shpronësimin e aseteve të të licencuarit kundrejt një kompensimi të drejtë, sipas procedurave të parashikuara në ligjin nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik".

Neni 19

Ndryshimet e licencës

(Ndryshuar pika 1 dhe 2 me ligjin nr. 9913, datë 5.5.2008)

1. Çdo i licencuar mund të kërkojë ndryshim të licencës. ERE-ja mund të bëjë ndryshime të afateve dhe të kushteve të licencës, me kërkesë të të licencuarit, pasi të ketë vlerësuar efektet e ndryshimit të propozuar, ndaj detyrimeve të të licencuarit, sipas këtij ligji dhe licencës së tij, si dhe me kusht që ndryshimet jo vetëm të jenë kërkuar me shkrim, por edhe të jenë pranuar nga i licencuari.

2. ERE-ja kërkon ndryshimin e kushteve të një licence, kur ndryshon kuadri ligjor dhe nënligjor, që rregullon veprimtarinë në sektorin e energjisë elektrike.

3. Për ndryshimin e licencës zbatohen dispozitat e mëposhtme:

a) ERE-ja boton një njoftim të aplikimit të të licencuarit sipas formës së përcaktuar në rregulloren e procedurave të licencimit;

b) ERE-ja nuk mund të bëjë asnjë ndryshim para se të ketë marrë të gjitha vërejtjet dhe ankesat për këtë aplikim brenda dy muajve nga botimi i parë i aplikimit dhe pasi t'i ketë analizuar ato.

4. ERE-ja, para se të miratojë ndryshimin e një licence, me kërkesën e të licencuarit, boton ndryshimet e propozuara dhe analizon të gjitha vërejtjet dhe ankesat e marra për ndryshimet e propozuara brenda dy muajve nga botimi i parë i njoftimit.

Neni 20

Ndalimi i transferimit të aseteve

(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 9913, datë 5.5.2008)

1. Asnjë i licencuar nuk mund ta transferojë licencën ose ndonjë aset të tij, që përdoret në veprimtarinë, për të cilën është licencuar, nëpërmjet shitjes, pengut, qirasë, shkëmbimit ose formave të tjera, pa miratimin me shkrim të ERE-së.

2. Brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ERE-ja miraton një rregullore për shqyrtimin dhe miratimin e shitjes, dhënies me qira, transferimit ose ndryshimeve të tjera të çdo aseti të të licencuarit ose të pronësive të përcaktuara për prodhimin, transmetimin ose shpërndarjen, sipas nenit 3 të këtij ligji, përfshirë përjashtimet nga miratimi për asetet me vlerë minimale.

Neni 21

Sistemet e njëjta dhe të standardizuara të llogarive

Brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ERE-ja harton dhe miraton një sistem të njëjtë dhe të standardizuar llogarish për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike, mbështetur në legjislacionin shqiptar dhe standardet e pranura ndërkombëtare të kontabilitetit. Raportimi vjetor financiar dhe ekonomik bëhet në ERE nga të gjithë të licencuarit, sipas këtij sistemi.

Neni 22

Raportet vjetore të të licencuarit

(Shtuar fjalë në shkronjën "a" të pikës 1 me ligjin nr. 9913, datë 5.5.2008)

1. Të licencuarit paraqesin në ERE, jo më vonë se tre muaj nga përfundimi i vitit, bilanci të plota financiare. Në këto raporte vjetore përfshihen:

a) përmbledhjet e të ardhurave dhe shpenzimeve për çdo veprimtari të veçantë të prodhimit, transmetimit, furnizimit publik, me shumicë dhe pakicë dhe shpërndarjes;

b) përmbledhjet e të ardhurave dhe shpenzimeve përkatëse për të gjitha degët e ndërmarrjes dhe një përmbledhje të rregullave, sipas të cilave janë shpërndarë të ardhurat, asetet e shpenzuara dhe përgjegjësitë ndërmjet veprimtarive të biznesit dhe degëve;

c) materiale të tjera shtesë, që mund të kërkojnë nga ERE-ja.

2. Këto bilance financiare duhet të jenë në përputhje me sistemin e njëjtë dhe standard të llogarive, pasi të jenë miratuar nga ERE-ja, sipas nenit 21 të këtij ligji.

Neni 23

Mbajtja e bilanceve të llogarive

(Ndryshuar me ligjin nr. 9913, datë 5.5.2008)

Çdo shoqëri e licencuar në sektorin e energjisë elektrike, e cila kryen më shumë se një nga veprimtaritë, që kanë të bëjnë me prodhimin, transmetimin, shpërndarjen dhe furnizimin publik, me shumicë ose me pakicë, mban llogari të ndara për çdo veprimtari, në njësinë e vet të llogarive, si dhe përgatit bilance llogarish të konsoliduara, në përputhje me praktikën e kërkuar të llogarive. Këto shoqëri mbajnë, gjithashtu, llogari të ndara për veprimtaritë, që nuk lidhen me ato të prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit publik, me shumicë ose me pakicë, të energjisë elektrike.

Neni 24

Programet e investimeve
(Ndryshuar me ligjin nr. 9913, datë 5.5.2008)

1. Të licencuarit, që kryejnë njërën prej veprimtarive të gjenerimit publik, të transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit publik, paraqesin në ERE për miratim planet e tyre të investimeve për 3 vitet e ardhshme.

2. Të licencuarit, subjekte të pikës 1 të këtij neni, janë të detyruar të paraqesin në ERE, brenda datës 31 tetor të çdo viti, planet e përditësuara të investimeve për vitin pasardhës.

3. Për ata të licencuar, që aplikojnë për tarifë, për një periudhë rregullatore më të madhe se një vit, plani i investimeve duhet të përmbajë një analizë të investimeve të planifikuara për periudhën rregullatore përkatëse.

4. ERE-ja harton dhe miraton, brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, një rregullore për procedurat e paraqitjes dhe të miratimit të planeve të investimeve.

Neni 25

Detyrimet e shërbimit publik

1. Veprimtaritë e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes, furnizimit me energji elektrike të klientëve të mandatuar tariforë, organizimi i tregut të energjisë elektrike dhe funksionimi i sistemit elektroenergjetik realizohen si shërbime publike.

2. Gjatë zbatimit të shërbimeve publike ndaj të licencuarve, ERE-ja merr parasysh detyrimet lidhur me:

- a) sigurinë e furnizimit;
- b) rregullsinë, cilësinë dhe çmimin e furnizimit;
- c) përdorimin e burimeve vendase të energjisë;
- ç) përdorimin e frytshëm të lëndëve djegëse dhe energjisë;
- d) mbrojtjen e mjedisit;
- dh) mbrojtjen e shëndetit, jetës dhe pronës së njerëzve.

3. I licencuari nuk ka si detyrim të shërbimit publik për të siguruar shërbim në një zonë ku nuk ofrohet ky shërbim në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç rastit kur kërkohet nga rregulloret e miratuara nga ERE-ja. Këto rregullore parashikojnë një ndarje të drejtë të kostove shtesë për të siguruar këtë shërbim, ndërmjet klientëve që kërkojnë shërbimin dhe klientëve ekzistues të të licencuarit.

4. Kostot e realizuara nga çdo i licencuar, sipas detyrimeve të shërbimit publik, janë në përputhje me nenet 27 dhe 28 të këtij ligji.

PJESA E KATËRT

TARIFAT E ENERGJISË ELEKTRIKE

Neni 26

Autoriteti i ERE-së për vendosjen e tarifave
(Ndryshuar me ligjin nr. 9913, datë 5.5.2008)

1. ERE-ja është institucioni përgjegjës për vendosjen e tarifave të energjisë elektrike për të gjitha veprimtaritë e rregulluara, që kryhen nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike.

2. ERE-ja harton dhe miraton një rregullore për procedurat dhe standardet, sipas së cilës përcaktohen, miratohen, ndryshohen ose refuzohen tarifat, afatet dhe kushtet e shërbimeve të

energjisë elektrike.

3. ERE-ja harton dhe miraton një rregullore për mënyrën e përcaktimit të pagesave për detyrimet e shërbimit publik, si dhe për procedurat e shpërndarjes së drejtë të kostove të detyrimeve të shërbimit publik tek të gjithë klientët e blerjes me pakicë të energjisë elektrike.

4. Brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ERE-ja harton dhe miraton rregulloret e përcaktuara në pikat 2 e 3 të këtij neni.

Neni 27

Parimet e vendosjes së tarifave

1. Tarifat për shërbimet e energjisë elektrike, të vendosura nga ERE-ja, kanë për qëllim:

- a) të mbrojnë konsumatorët nga çmimet monopol;
- b) t'u sigurojnë të licencuarve mundësi për të shlyer kostot e shërbimit;
- c) të nxisin efikasitetin në veprimet e brendshme dhe praktikën e menaxhimit, duke lejuar rritjen e shlyerjes financiare të të licencuarit, si rezultat i minimizimit të kostove të shërbimit, duke përmbushur të gjitha kërkesat e licencës për vazhdueshmërinë dhe cilësinë e shërbimit;
- ç) të nxisin efikasitetin ekonomik brenda sektorit të energjisë elektrike, duke reflektuar kostot marxhinale afatshkurtra dhe afatgjata dhe duke u dhënë të licencuarve sinjale të kujdesshme çmimesh;
- d) marrjen parasysh të politikës së Këshillit të Ministrave për konsumatorët parësorë të furnizimit me energji elektrike, me kusht që të mos pengojë të licencuarin të shkëpusë çdo person juridik ose fizik, për shkak të mospagimit të energjisë elektrike të konsumuar, siç jepet në kontratë ose në kushtet e miratuara të shërbimit;
- dh) marrjen parasysh të politikës së Këshillit të Ministrave lidhur me subvencionet e mundshme, duke ndaluar subvencionimin e çdo kategorie konsumatorësh për llogari të të licencuarit ose të çdo kategorie tjetër konsumatorësh;
- e) të reflektojnë diferencat e kostove ndërmjet kategorive të ndryshme të konsumatorëve.

2. Tarifat janë në përputhje me parimet e njohura të përcaktimit të tarifave jodiskriminuese, të përcaktuara në mënyrë transparente dhe të bazuara në kritere objektive.

3. Kostot mbulohen nga çdo kategori konsumatorësh, në raport me kostot e shërbimit të kësaj kategorie.

4. Për çdo kategori konsumatorësh mund të vendosen tarifa të ndryshme, duke marrë parasysh stinën, ndarjen kohore, ditë ose natë, periudhën e pikut të ngarkesës, përdorimin mesatar ose të përgjithshëm ose parametra të ngjashëm me to.

Neni 28

Rregullat për vendosjen e tarifave

1. ERE-ja përcakton metodat dhe procedurat për të llogaritur shifrat ekonomike dhe financiare, për vendosjen e tarifave për çdo veprimtari në sektorin e energjisë elektrike.

2. Gjatë shqyrtimit të tarifave të paraqitura për miratim nga një i licencuar, ERE-ja merr parasysh:

- a) kostot për prodhimin ose blerjen e energjisë elektrike;
- b) kostot operative të mirëmbajtjes dhe riparimit, duke përfshirë shpenzimet e amortizimit;
- c) kostot e mbajtjes së kapaciteteve rezervë dhe rregulluese, të kërkuara për një furnizim të qëndrueshëm me energji elektrike;
- ç) kostot për lëndë djegëse dhe mbajtjen e rezervave me lëndë djegëse;
- d) kostot për mbrojtjen e mjedisit;

- dh) kostot për pagat dhe shpenzime të ngjashme;
 - e) taksat dhe detyrimet e tjera fiskale, të parashikuara nga legjislacioni shqiptar;
 - ë) pagesat e licencës dhe të rregullimit, siç parashikohen nga ky ligj;
 - f) kthimin e kapitalit të investuar, duke marrë parasysh riskun e biznesit dhe koston kapitale;
 - g) kostot e përmbushjes së detyrimeve të shërbimit publik, siç parashikohen nga ky ligj;
 - gj) kostot e programeve të ruajtjes së energjisë.
3. ERE-ja nuk përfshin në normat e tarifave kostot që përmbajnë shpenzime të tepërta dhe të paargumentuara, si rezultat i mosefiçencës së të licencuarit.
4. Rritja e tarifave nuk mund të bëhet më shumë se një herë brenda një viti financiar, përveç rasteve kur ERE-ja e lejon këtë pas paraqitjes së një arsyetimi të bazuar.

Neni 29

Periudha e tranzicionit për rritjen e tarifave
(Shfuqizuar me ligjin nr. 9913, datë 5.5.2008)

PJESA E PESTË
SISTEMI ELEKTROENERGJETIK

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 30

Përbërja e sistemit elektroenergjetik

1. Sistemi elektroenergjetik i vendit përbëhet nga centralet prodhuese, sistemi i transmetimit me pajisjet përkatëse të interkonjeksionit dhe të sistemit të komunikimit e të informacionit, rrjetet e shpërndarjes dhe pajisjet elektrike të konsumatorëve.
2. Sistemi elektroenergjetik funksionon si një sistem i integruar dhe me proces të vazhdueshëm prodhimi, transformimi, transmetimi dhe shpërndarjeje të energjisë elektrike.

Neni 31

Interkonjeksioni me sistemet e tjera elektroenergjetike

1. Sistemi elektroenergjetik i vendit lidhet me sistemet elektroenergjetike të vendeve të tjera nëpërmjet linjave të interkonjeksionit. Këto linja ndërtohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë.
2. Funksionimi i sistemit elektroenergjetik, në paralel me sisteme të tjera elektroenergjetike dhe sisteme të ndërlidhura elektroenergjetike, kryhet në përputhje me marrëveshjet dy ose shumëpalëshe në fushën e elektroenergjisë, duke respektuar standardet teknike dhe kërkesat e funksionimit të sigurt, si dhe standardet e tjera të interkonjeksionit, të përcaktuara nga ERE-ja, sipas nenit 55 të këtij ligji.

Neni 31/1

(Shtuar pika 21/1 me ligjin nr. 9776, datë 12.7.2007)

1. Ndërtimi i linjave tregtare të interkonjeksionit miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, kur plotësohen kushtet e mëposhtme:
- a) ndërtimi i linjës nuk cenon qëndrueshmërinë dhe sigurinë e operimit të sistemit

elektroenergjetik kombëtar;

b) linja tregtare e interkonjeksionit është në pronësi të një subjekti, person ligjërishit i ndarë nga Operatori i Sistemit të Transmetimit;

c) të gjitha shpenzimet për ndërtimin dhe lidhjen e linjës me sistemin e transmetimit përballohen nga vetë investitori;

ç) asnjë pjesë e kostove, kapitale dhe operacionale, të linjës tregtare të interkonjeksionit nuk përfshihet në kostot e Operatorit të Sistemit të Transmetimit;

d) investitori bie dakord që 20 për qind e kapacitetit të linjës tregtare të interkonjeksionit të shfrytëzohet për përdorim publik nga Operatori i Sistemit të Transmetimit.

2. Këshilli i Ministrave, përpara miratimit të linjave tregtare të interkonjeksionit, merr mendimin e Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike dhe të Operatorit të Sistemit të Transmetimit.

3. Afati i shfrytëzimit të linjës tregtare të interkonjeksionit nga investitori është 20 vjet. Pas mbarimit të këtij afati, asetet kalojnë në pronësi të Operatorit të Sistemit të Transmetimit.

4. Operimi i linjave tregtare të interkonjeksionit bëhet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit, sipas dispozitave të kodit të funksionimit të rrjetit dhe rregullave të tregut.

5. Mirëmbajtja e linjave tregtare të interkonjeksionit është përgjegjësi e investitorit privat gjatë gjithë kohës që ai ka në pronësi këtë linjë.

6. Kapaciteti i linjës së interkonjeksionit, që shfrytëzohet për interes publik, sipas shkronjës “d” të pikës 1 të këtij neni, shpërndahet në përputhje me rregullat e miratuara nga ERE.

Neni 32

Standardet teknike dhe të sigurisë së sistemit elektroenergjetik

1. Instalimet e prodhimit, të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, së bashku me ato të projektuara për marrjen e energjisë elektrike nga përdoruesit, si dhe elementet dhe materialet teknike për instalimet e sistemit elektroenergjetik, duhet të plotësojnë standardet teknike dhe të sigurisë, në përputhje me aktet nënligjore, të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

2. Aktet nënligjore të parashikuara në pikën 1 të këtij neni duhet të garantojnë:

a) mbrojtjen e individit dhe pasurisë, që mund të dëmtohen nga instalimet;

b) arritjen e rregullsisë së kërkuar të furnizimeve me energji elektrike;

c) vendosjen e standardeve për të lehtësuar inspektimin e instalimeve dhe njësimin e kushteve të furnizimit;

ç) rritjen e qëndrueshmërisë së instalimeve dhe përmirësimin e cilësisë së furnizimit me energji elektrike;

d) mbrojtjen e mjedisit, të drejtave dhe interesave të konsumatorëve;

dh) arritjen e standardeve të kërkuara në përdorimin e energjisë elektrike.

Neni 33

Ndarja e veprimtarive

(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 9913, datë 5.5.2008)

1. Jo më vonë se 6 muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, çdo shoqëri, që kryen veprimtarinë e prodhimit, të transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë elektrike duhet t'i mbajë llogaritë financiare të ndara, për secilën prej këtyre veprimtarive.

2. Çdo shoqëri që ushtron prodhimin, shpërndarjen dhe furnizimin me energji elektrike, që merret edhe me veprimtari të tjera joelektroenergjetike, mban regjistrime të ndara të llogarive për veprimtaritë e prodhimit, shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë elektrike, duke shmangur diskriminimin, ndërsuvencionimin dhe shtrembërimin e konkurrencës. Ajo mban llogari të

veçanta për çdo veprimtari si të ishin shoqëri të veçanta.

KREU II PRODHIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE

Neni 34

I licencuari në prodhimin e energjisë elektrike

1. Prodhimi i energjisë elektrike mund të kryhet nga një person fizik ose juridik, që ka licencën për prodhimin e energjisë elektrike, sipas dispozitave të Pjesës së Tretë të këtij ligji.

2. Veprimtaria e prodhimit përfshin edhe transformimin e energjisë elektrike të prodhuar nga impiantet dhe lidhjen me rrjetin e transmetimit ose të shpërndarjes.

3. Dhënia e licencës së prodhimit nuk e përjashton mbajtësin e saj nga detyrimi për të marrë autorizime ose miratime të tjera, që parashikohen nga legjislacioni në fuqi.

4. Në rastin e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet, prodhuesi duhet të marrë më parë lejen administrative, për përdorimin e ujit për qëllime publike nga institucionet përgjegjëse, siç parashikohet nga legjislacioni në fuqi.

Neni 34/1

Ndërtimi i burimeve të reja gjeneruese

(Shtuar me ligjin nr. 9913, datë 5.5.2008; shtuar pika 2 nr. 10 137, datë 11.5.2009)

1. Ndërtimi i burimeve të reja gjeneruese, kur nuk është miratuar me një kontratë koncesionare, bëhet me miratimin e Këshillit të Ministrave.

2. Këshilli i Ministrave, brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, miraton një rregullore për procedurat dhe kriteret e dhënies së lejeve, të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni.

2. Ndërtimi i burimeve të reja gjeneruese, sipas pikës 1 të nenit 34/1, të këtij ligji, përfshihet në kategorinë IV.3, të shtojcës së ligjit për licencat. Këto leje miratohen në përputhje me dispozitat në vijim, të këtij ligji. Miratimi në heshtje nuk zbatohet në rastin e këtyre lejeve.

3. Kriteret për dhënien e lejeve marrin parasysh:

- a) sigurinë e sistemit elektroenergjetik;
- b) mbrojtjen e shëndetit dhe të jetës së publikut;
- c) mbrojtjen e mjedisit;
- ç) përdorimin e tokës;
- d) efikasitetin e energjisë;
- dh) llojin e burimit parësor të energjisë;
- e) karakteristikat e aplikuesit për aftësitë teknike, ekonomike dhe financiare.

4. Këshilli i Ministrave, me miratimin e lejes për ndërtimin e një burimi të prodhimit të energjisë elektrike, kur e sheh të nevojshme, ka të drejtë të kërkojë që një pjesë e prodhimit t'i shitet furnizuesit publik me shumicë, me çmime të rregulluara nga ERE-ja, për nevoja të klientëve tariforë.

Neni 35

Të drejtat dhe përgjegjësitë e prodhuesit

1. Prodhuesi ka të drejtë:

a) të përdorë në impiantin e vet ato burime parësore energjie që përcaktohen në licencë, duke ruajtur kapacitetin prodhues, karakteristikat teknike dhe kushtet e mbrojtjes së mjedisit;

b) të kontraktojë për shitjen e energjisë elektrike, sipas kushteve të vendosura në këtë ligj, në rregulloret e ERE-së dhe në rregullat e tregut të miratuara nga ERE-ja;

c) të dispeçerojë energjinë elektrike, nëpërmjet operatorit të sistemit të transmetimit;

ç) të kenë akses në rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes, nëpërmjet një pagese të bazuar në tarifat e transmetimit të vendosura nga ERE-ja;

d) të marrë pagesat që i përkasin sipas kontratës.

2. Prodhuesi është i detyruar:

a) të zbatojë kushtet e vendosura në licencat e prodhimit;

b) të përmbushë kodet e zbatueshme të funksionimit të rrjetit, rregullat e tregut dhe rregulloret e tjera;

c) të pajiset me aparate matëse, për matjen e energjisë elektrike që kalon në rrjetin përkatës;

ç) të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga aktet e tjera ligjore dhe nënligjore, që lidhen me shfrytëzimin e centraleve të prodhimit të energjisë elektrike.

Neni 36

Rezervat e lëndëve djegëse ose të kapacitetit prodhues

1. Për të siguruar një furnizim të qëndrueshëm për klientët, personi që prodhon energji elektrike duhet të mbajë rezerva të veçanta lënde djegëse ose kapacitete të veçanta rezervë prodhimi të energjisë elektrike.

2. Tipi, sasia e rezervave të lëndëve djegëse dhe kapaciteti rezervë për tipa të veçantë të centraleve prodhuese përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Kostot e rezervave të lëndës djegëse dhe të kapaciteteve rezervë trajtohen si kosto operative.

Neni 37

Kostot e lidhjes me rrjetin

Kostot e lidhjes së një prodhuesi të ri, të pavarur, të energjisë ose të një vetëprodhuesi dhe kostot në rrjetin e transmetimit ose të shpërndarjes, që lidhen me të, përballohen nga prodhuesi, në përputhje me kodin e funksionimit të rrjetit ose me kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji elektrike. Operatori i sistemit ka të drejtën e pronësisë mbi këtë lidhje.

Neni 38

Prodhuesit e privilegjuar të energjisë elektrike

1. Prodhuesi i privilegjuar i energjisë elektrike është:

a) prodhuesi që prodhon energji elektrike nëpërmjet përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë, kapaciteti i instaluar i të cilave është deri në 25 MW dhe, në rast të burimeve hidroelektrike të energjisë, deri në 10 MW;

b) prodhuesi që prodhon energji elektrike nëpërmjet skemave të bashkëprodhimit, kapaciteti i instaluar i të cilave nuk është më i madh se 100 MW;

c) vetëprodhuesi për tepicën e tij të energjisë elektrike, nëse ai përdor burime të energjive të rinovueshme dhe kapaciteti i tij i instaluar nuk është më i madh se 10 MW.

2. ERE-ja ka autoritetin t'i japë statusin e prodhuesit të privilegjuar prodhuesit që plotëson kushtet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, i cili gëzon një trajtim favorizues nga

operatori i sistemit të transmetimit në dispeçerimin e energjisë elektrike të prodhuar prej tij.

3. Mënyra, shtrirja, afatet dhe kushtet sipas të cilave operatori i sistemit të transmetimit i bën trajtim favorizues prodhuesit të privilegjuar të energjisë elektrike, përcaktohen në kodin e funksionimit të rrjetit. Favorizimi nuk prek zbatimin e parimit të kostos më të ulët në veprimtarinë e prodhimit.

Neni 39

Burimet e energjive të rinovueshme

(Shtuar pikat 3 dhe 4 me ligjin nr. 9913, datë 5.5.2008; ndryshuar me ligjin nr. 10 196, datë 10.12.2009)

1. Prodhuesit e pavarur të energjisë elektrike nga burime jo të rinovueshme energjie, me kapacitet mbi 50 MW, janë të detyruar të prodhojnë dhe/ose injektojnë në sistemin elektroenergjetik energji elektrike në masën jo më pak se 3 për qind të prodhimit të tyre të përgjithshëm vjetor të vitit pararendës, nga centrale prodhues që përdorin burime të rinovueshme të energjisë, të certifikuara nga ERE me “Certifikatë të gjelbër” dhe të vëna në punë pas datës 2.11.2000.

2. Për periudhën 2010-2012 kuota e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni do të rritet çdo vit me 0,75 për qind.

3. Detyrimi i mësipërm është i përmbushur nëse ata blejnë sasi të njëjta të energjisë elektrike nga prodhues të tjerë të burimeve të rinovueshme. Në këtë rast, detyrimi vlerësohet i përmbushur, kur ERE-ja ose institucionet simotra të vendeve nga importohet energjia elektrike kanë një proces të ndërsjellë certifikimi për prodhimin nga burimet e energjive të rinovueshme.

4. Këshilli i Ministrave autorizohet të ndërmarrë nisma nxitëse dhe mbështetëse për ndërtimin e centraleve, që shfrytëzojnë energjitë e rinovueshme për prodhimin e energjisë elektrike, që do të konsumohet tërësisht brenda vendit.

5. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë mekanizmat e nxitjes së ndërtimit të centraleve, që shfrytëzojnë energjitë e rinovueshme, si dhe të përcaktojë masën e incentivave për ndërtimin e këtyre centraleve.

6. Për centralet prodhuese të energjisë elektrike, që përdorin burime të rinovueshme energjie, të lidhur në rrjetin e shpërndarjes, prodhimi i të cilave është i destinuar për mbulimin e nevojave të klientëve tariforë dhe që nuk përfitojnë “Certifikatën e gjelbër”, Këshilli i Ministrave, në bashkëpunim me ERE-në, miraton metodologjinë e llogaritjes së tarifave (feed-in tariff) të shitblerjes së energjisë që prodhojnë.

KREU III

TRANSMETIMI I ENERGISË ELEKTRIKE

Neni 40

Sistemi i transmetimit

1. Sistemi i transmetimit të energjisë elektrike përbëhet nga linja dhe stacione transformuese elektrike ose çdo instalim tjetër, funksioni i të cilave përfshin transmetimin ose interkonjeksionin ndërkombëtar.

2. Çdo aset që përfshin komunikimin, mbrojtjen, kontrollin, shërbimet ndihmëse, truallin, ndërtesat dhe asete të tjera ndihmëse, elektrike ose jo, të cilat nevojiten për funksionimin e duhur të instalimeve të veçanta të sistemit të transmetimit, janë elemente përbërëse të sistemit të transmetimit.

Neni 41

Operatori i sistemit të transmetimit

(Shfuqizuar shkronja "d", shtuar pika 4 me ligjin nr. 9512, datë 10.4.2006; shtuar shkronja "d" me ligjin nr. 9776, datë 12.7.2007; ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 9913, datë 5.5.2008)

1. Sistemi i transmetimit drejtohet nga një operator i sistemit të transmetimit, i cili ka licencë për të kryer veprimtarinë e transmetimit të energjisë elektrike.

2. Operatori i sistemit të transmetimit është përgjegjës për zhvillimin dhe zgjerimin e sistemit të transmetimit, si dhe për menaxhimin e çdo tranzitimi të energjisë elektrike, ndërmjet sistemeve të huaja, që shfrytëzojnë rrjetin shqiptar të energjisë elektrike.

3. Operatori i sistemit të transmetimit të energjisë elektrike:

a) garanton kapacitetin afatgjatë të sistemit, për të përballuar kërkesën e arsyeshme të transmetimit të energjisë elektrike;

b) kontribuon në sigurinë e furnizimit, nëpërmjet kapacitetit të duhur të transmetimit, si dhe të besueshmërisë së sistemit;

c) menaxhon flukset e energjisë së sistemit, duke marrë parasysh edhe shkëmbimet me sistemet e tjera;

ç) siguron disponibilitetin e të gjitha shërbimeve ndihmëse të nevojshme, në një masë të tillë, që ky disponibilitet të jetë i pavarur nga çdo sistem tjetër transmetimi, me të cilin është i ndërlidhur;

d) i siguron çdo operatori tjetër të transmetimit, të lidhur me të, informacion të mjaftueshëm, për të garantuar funksionimin e sigurt dhe eficient, zhvillimin e bashkërenduar dhe ndërveprueshmërinë e sistemeve të ndërlidhura;

dh) garanton mosdiskriminimin e përdoruesve të veçantë ose të kategorive të përdoruesve të sistemit të transmetimit;

e) u ofron përdoruesve të sistemit informacion të mjaftueshëm për një hyrje eficiente në sistem;

ë) operon linjat tregtare të interkonjeksionit.

4. Operatori i sistemit të transmetimit kryen edhe funksionet e operatorit të tregut të energjisë elektrike, në përputhje me aktet e tjera nënligjore në fushën e energjisë elektrike.

Neni 42

Kodi i funksionimit të rrjetit

1. Funksionimi i sistemit të transmetimit kryhet në përputhje me dispozitat e kodit të funksionimit të rrjetit, që miratohet nga ERE-ja, sipas nenit 55 të këtij ligji.

2. Kodi i funksionimit të rrjetit rregullon:

a) kushtet për paraqitjen e një aplikimi për të drejtë hyrjeje në sistem dhe dokumentet përkatëse;

b) specifikimet minimale, teknike dhe funksionale, për të siguruar hyrjen dhe lidhjen me sistemin e transmetimit të instalimeve prodhuese, të shoqërive të shpërndarjes, të klientëve të kualifikuar, si dhe të interkonjeksionit me rrjetet e tjera;

c) afatin kohor, brenda të cilit operatori i sistemit të transmetimit është i detyruar t'i përgjigjet aplikimit të paraqitur, si dhe pasojat e mospërgjigjes brenda afatit;

ç) kriteret e zbatuara nga operatori i sistemit, për shpërndarjen nga qendra e dispeçerisë të ngarkesës në instalimet e disponueshme prodhuese, si dhe për përdorimin e interkonjeksioneve;

d) mënyrën, shtrirjen, afatet dhe kushtet në të cilat operatori i sistemit të transmetimit, kur dispeçeron instalimet e prodhimit, u jep përparësi instalimeve të prodhimit, që përdorin

burime të rinovueshme të energjisë, si dhe instalimeve bashkëprodhuese;

dh) çdo hollësi tjetër, të nevojshme për rregullimin e funksionimit të sistemit të transmetimit.

3. ERE-ja miraton rregullore për të lehtësuar hyrjen në rrjet të centraleve elektrike me kapacitet të përgjithshëm jo më të madh se 5 MW.

KREU IV SHPËRNDARJA E ENERGJISË ELEKTRIKE

Neni 43

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (Ndryshuar me ligjin nr. 9913, datë 5.5.2008)

1. Rrjeti i shpërndarjes zotërohet dhe operohet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, që ka një licencë për kryerjen e veprimtarisë në fushën e shpërndarjes së energjisë elektrike.

2. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes:

a) mban një sistem shpërndarjeje të sigurt, të qëndrueshëm dhe eficient, duke respektuar kushtet mjedisore;

b) zhvillon rrjetin e shpërndarjes, në përputhje me perspektivat e zhvillimit ekonomik dhe të parashikimeve të ndryshimit të kërkesës në vend;

c) lidh të gjithë klientët ose prodhuesit e vegjël të energjisë elektrike, sipas dispozitave të kodit të shpërndarjes;

ç) u siguron përdoruesve të sistemit të drejta të njëjta dhe pa diskriminim hyrjeje në rrjetin e shpërndarjes;

d) u siguron përdoruesve të sistemit informacionin e nevojshëm për hyrjen dhe operimin eficient në rrjetin e shpërndarjes;

dh) ruan konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar, që merr gjatë kryerjes së veprimtarisë;

e) siguron shërbime të tjera, të nevojshme për klientët, për të përmbushur detyrimet, sipas këtij neni.

3. Funksionet për kryerjen e furnizimit me energji elektrike të klientëve, të lidhur në sistemin e shpërndarjes, përmbushen nga furnizuesi publik me pakicë.

Neni 44

Kodi i Funksionimit të Shpërndarjes (Shfuqizuar pika 4 me ligjin nr. 9913, datë 5.5.2008)

1. Funksionimi i rrjetit të shpërndarjes kryhet në përputhje me dispozitat e Kodit të Funksionimit të Shpërndarjes, që miratohet nga ERE-ja.

2. Për hartimin dhe miratimin e Kodit të Funksionimit të Shpërndarjes, ERE-ja bashkëpunon me të gjithë pjesëmarrësit e sektorit të energjisë.

3. Kodi i Funksionimit të Shpërndarjes përcakton afatet standarde dhe kushtet e shërbimit, përfshirë kontratën e përgjithshme të shoqërisë, ndërmjet një klienti dhe shoqërisë shpërndarëse, si dhe rrethanat në të cilat disa afate dhe kushte mund të trajtohen nga kontrata të veçanta, ndërmjet klientëve dhe shoqërisë së shpërndarjes.

4. Shfuqizuar.

KREU V FURNIZIMI ME ENERGJI ELEKTRIKE

Neni 45

Veprimtaritë e furnizimit me energji elektrike

(Ndryshuar pikat 1 dhe 2 me ligjin nr. 9512, datë 10.4.2006; ndryshuar me ligjin nr. 9913, datë 5.5.2008)

1. Furnizimi i klientëve tariforë kryhet nga furnizuesi publik me pakicë, me tarifa të rregulluara nga ERE-ja.
2. Furnizuesi publik me pakicë e siguron energjinë elektrike për furnizimin e klientëve tariforë nga furnizuesi publik me shumicë.
3. Furnizimi i klientëve të kualifikuar kryhet nga furnizuesit e kualifikuar, sipas kushteve të marrëveshjeve dypalëshe, për të cilat ata kanë rënë dakord.
4. Licenca e furnizuesit të kualifikuar nuk jepet në bazë monopoli dhe me të drejta ekskluzive.

Neni 46

Të drejtat dhe detyrimet e furnizuesve

(Shtuar fjalë në shkronjën "c" me ligjin nr. 9750, datë 4.6.2007; ndryshuar me ligjin nr. 9913, datë 5.5.2008; shfuqizuar fjalë në shkronjën "c" me ligjin nr. 9997, datë 22.9.2008)

1. Furnizuesi publik me shumicë ka të drejtat dhe detyrimet si më poshtë:
 - a) blen energji elektrike nga gjenerimi publik, prodhuesit e pavarur të energjisë elektrike, prodhuesit e vegjël të energjisë elektrike dhe tregtuesit, për nevojat e klientëve tariforë;
 - b) shet energji elektrike me tarifa të rregulluara të furnizuesi publik me pakicë;
 - c) shërben si furnizues i alternativës së fundit për të gjitha kategoritë e klientëve;
 - ç) zbaton kushtet e licencës së furnizimit publik me shumicë;
 - d) përmbush të gjitha detyrimet e tjera, që rrjedhin nga zbatimi i këtij ligji dhe legjislacioni ose rregulloret përkatëse në fuqi.
2. Furnizuesit me pakicë kanë të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:
 - a) zbatojnë kushtet e licencës së furnizimit me pakicë të klientëve;
 - b) plotësojnë kërkesat e klientëve për energji elektrike, në përputhje me kushtet e kontratës;
 - c) marrin pagesat që u takojnë, sipas kontratave;
 - ç) blejnë energjinë elektrike, që u nevojitet për të furnizuar klientët;
 - d) kanë të drejtë hyrjeje në rrjet, siç përcaktohet nga ky ligj dhe nga rregulloret e tjera, të miratuara nga ERE-ja;
 - dh) lexojnë matësat dhe lëshojnë faturat e konsumit të energjisë elektrike për klientët e tyre;
 - e) përmbushin të gjitha detyrimet e tjera, që rrjedhin nga zbatimi i këtij ligji dhe legjislacioni ose rregulloret përkatëse në fuqi.

Neni 46/1

(Shtuar me ligjin nr. 9750, datë 4.6.2007; shfuqizuar me ligjin nr. 9997, datë 22.9.2008)

Neni 47

Gjendja emergjente në furnizimin me energji elektrike

1. Këshilli i Ministrave shpall gjendjen emergjente në furnizimin me energji elektrike në rastet:

- a) e një force madhore;
 - b) kur autoritetet qeveritare marrin masa për të siguruar mbrojtjen, në një gjendje gatishmërie;
 - c) kur ndodhin aksidente në pajisjet e prodhimit, të transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike;
 - ç) kur ka mungesa afatgjata të burimeve energjetike, të rëndësishme për prodhimin e energjisë elektrike.
2. Gjatë gjendjes së emergjencës, i licencuari dhe klienti duhet t'u përmbahen kufizimeve në përdorimin e energjisë elektrike. Ministri përgjegjës për energjinë, nëpërmjet një rregulloreje të veçantë, përcakton zgjatjen dhe mënyrën e kufizimit të furnizimit me energji elektrike.
3. Të licencuarit ose furnizuesit e tjerë nuk përgjigjen ligjërisht për kompensimin e dëmeve të shkaktuara, si rezultat i kufizimit ose ndërprerjes së energjisë elektrike në rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, përveç gjendjes së emergjencës të ndodhur si rezultat i gabimeve të të licencuarit ose të furnizuesit.

Neni 48

Klienti i kualifikuar

(Ndryshuar me ligjin nr. 9512, datë 10.4.2006; ndryshuar me ligjin nr. 10 485, datë 26.11.2011)

1. “Klient i kualifikuar” konsiderohet automatikisht çdo konsumator i energjisë elektrike, i lidhur në rrjetin e energjisë elektrike me tension 110 kV e sipër, si dhe çdo konsumator tjetër i energjisë elektrike që, pavarësisht nivelit të tensionit të rrjetit të energjisë elektrike, në të cilin është lidhur, ka një konsum vjetor të energjisë elektrike më të madh se 50 milionë kWh.
2. Klienti i kualifikuar lidh kontratë për furnizimin me energji elektrike me çdo furnizues të kualifikuar, vendas apo të huaj, të licencuar nga ERE-ja. Kontrata do të jetë në përputhje me rregullat e tregut të energjisë, të miratuara nga ERE-ja.

Neni 49

Linja e drejtpërdrejtë

Prodhuesi i energjisë elektrike, që dëshiron të përfundojë një kontratë me një klient të kualifikuar, pas miratimit të rregullave të tregut të energjisë elektrike dhe me lejen paraprake të ERE-së, kur nuk ka mundësi hyrjeje në rrjet, mund të ndërtojë një linjë të drejtpërdrejtë, në përputhje me rregullat e ERE-së.

Neni 50

Burimi zëvendësues

1. Furnizuesi përcakton kushtet teknike të instalimit të burimit zëvendësues, pronë e klientit, për furnizimin me energji elektrike të objekteve të tij, si dhe kushtet që duhet të plotësohen nga ky burim zëvendësues për të mos sjellë shqetësime në rrjetin e furnizuesit. Kushtet janë të detyrueshme për klientët.
2. Klienti që kërkon të instalojë burim zëvendësues, i bën furnizuesit një kërkesë me shkrim dhe siguron akses për përfaqësuesit e furnizuesit, për inspektime të burimit zëvendësues.
3. Furnizuesi ka të drejtë të ndërpresë furnizimin me energji elektrike për një klient, në rast se ky i fundit nuk i përmbush detyrimet, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni.

Matja e energjisë elektrike të furnizuar

(Ndryshuar me ligjin nr. 9913, datë 5.5.2008; ndryshuar me ligjin nr. 10 362, datë 16.12.2010)

1. Energjia elektrike, e përdorur nga klienti, lexohet dhe faturohet sipas regjistrimeve të aparateve matëse.

2. Instalimi i aparateve matëse të energjisë elektrike bëhet në përputhje me Kodin e Matjes të energjisë elektrike, të miratuar nga ERE-ja.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) verifikon tipin e miratuar të aparatit matës të energjisë elektrike, kur futet për herë të parë në treg dhe/ose kur vendoset për herë të parë në përdorim (instalim). Ky verifikim mund të bëhet nga një subjekt/organ tjetër i autorizuar për këtë qëllim, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. DPM-ja njofton ERE-n lidhur me këtë autorizim. DPM-ja miraton procedurat e verifikimit të aparateve matëse të energjisë elektrike të vendosura në treg për herë të parë.

4. Morseteria e aparatit matës të energjisë elektrike bashkëvulohet, pas instalimit te konsumatori, nga subjekti/organi i autorizuar dhe shpërndarësi me vula të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë.

5. DPM-ja në bashkëpunim me shpërndarësin dhe ERE-n, përcakton dokumentacionin e matjeve dhe kalendarin e kalimit të këtij dokumentacioni nga shpërndarësi te subjekti/organi i autorizuar.

6. Kalandari i inspektimit për verifikimin e aparateve matëse dhe të sistemit të matjes së energjisë elektrike bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

7. Inspektimi periodik për verifikimin e saktësisë së matësve dhe të sistemit të matjes së energjisë elektrike, kolaudimit dhe vulosjes bëhet nga subjekte/organe të autorizuar. Organi i autorizuar informon DPM-në dhe shpërndarësin për inspektimin periodik.

8. DPM-ja informon periodikisht ministrinë dhe ERE-n për inspektimet periodike të kryera.

9. Subjekti/organi i autorizuar për verifikimin e tipit të miratuar të aparateve matëse të energjisë elektrike, kur vendosen në treg përherë të parë dhe/ose në përdorim (instalim), dhe subjekti/organi i autorizuar për inspektimin periodik për verifikimin e saktësisë së aparateve matëse dhe të sistemit të matjes së energjisë elektrike, të kolaudimit, të vulosjes, si dhe të mirëmbajtjes së tyre, rregullojnë marrëdhëniet e tyre me shpërndarësin, sipas një kontrate tip, të propozuar nga DPM-ja dhe të miratuar nga ERE-ja.

10. Kur konsumatori dyshon në saktësinë e një matësi, ose kur ka vënë re pasaktësi në matës, bën kërkesë me shkrim te DPM-ja dhe/ose çdo organ tjetër për mbrojtjen e konsumatorit. DPM-ja është përgjegjëse për verifikimin e saktësisë së aparatit matës të energjisë elektrike, i cili kontrollohet nga DPM-ja ose një subjekt/organ i autorizuar, me kushtin që ky i fundit nuk është përfshirë më parë në verifikimin e saktësisë së këtij matësi. Kur pas kontrollit vërehen pasaktësi në matës, shpenzimet për riparimin apo zëvendësimin e tij, si dhe shpërblimi i dëmit të shkaktuar për këtë shkak janë në ngarkim të subjektit që ka shkaktuar dëmin. Shpërblimi i këtij dëmi bëhet sipas Kodit të Matjes dhe dispozitave të Kodit Civil.

Kur nuk vihet re ndonjë pasaktësi, shpenzimet e kontrollit paguhen nga ankuesi.

Procedura e paraqitjes së ankesës, mënyra e shqyrtimit të saj dhe afati i njoftimit të ankuesit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

11. Në rast të një mosmarrëveshjeje ndërmjet shpërndarësit dhe subjektit/organit të autorizuar, që lidhet me zbatimin e procedurave standarde të verifikimit, autorizohet DPM-ja të vendosë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, për të cilën njofton ministrinë dhe ERE-n.

12. Tarifat për shërbimet e ofruara nga subjekti/organi autorizuar, në bazë të nenit 40 të ligjit nr.9875, datë 14.2.2008 “Për metrologjinë”, të ndryshuar, miratohen me udhëzim të

përbashkët të Ministrit të Financave dhe të ministrit përgjegjës për ekonominë. Në relacionin shoqërues të këtij udhëzimi, DPM-ja dhe ERE-ja shprehin opinionin e tyre për tarifat e propozuara për miratim. ERE-ja merr parasysh koston e këtyre tarifave për të licencuarit në përcaktimin e çmimeve dhe të tarifave të energjisë elektrike.

13. Në sistemin e matjes së energjisë elektrike ndërhyt vetëm subjekti/organi i autorizuar, i cili, pas verifikimit, e vulos atë me vulë të miratuar nga DPM-ja. Vulosja duhet të bëhet pas çdo verifikimi të kryer nga subjekti/organi i autorizuar vetëm në prani të shpërndarësit.

14. Llogaritja e dëmit ekonomik, shkaktuar kompanisë nga çdo ndërhyrje e paligjshme, bëhet në përputhje me metodologjinë përkatëse të miratuar nga ERE-ja.

Neni 52

Klientët pa matës

(Ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 9512, datë 10.4.2006; ndryshuar me ligjin nr. 9913, datë 5.5.2008)

1. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është i detyruar të pajisë me sistem matjeje çdo klient të lidhur në sistemin e shpërndarjes.

2. Për klientët, që në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk janë të pajisur me aparat matës, për një periudhë tranzitore, furnizuesi i propozon për miratim ERE-së një përdorim të përllogaritur aforfe për këtë kategori klientësh, duke marrë parasysh kriteret e vendosura nga ERE-ja. Klienti, që nuk ka aparat matës, paguan në përputhje me këtë përllogaritje.

3. ERE-ja, në licencën e shpërndarjes ose furnizimit me energji elektrike, që i jep operatorëve, përcakton afatin e kohëzgjatjes së periudhës tranzitore, sipas pikës 2 të këtij neni.

PJESA E GJASHTË

TREGU I ENERGJISË ELEKTRIKE

Neni 53

(Ndryshuar me ligjin nr. 9913, datë 5.5.2008)

1. ERE-ja harton dhe, pasi merr mendimet e pjesëmarrësve të tjerë të sektorit të energjisë elektrike, i propozon Këshillit të Ministrave, nëpërmjet ministrit përgjegjës për energjinë, modelin e tregut të energjisë elektrike.

2. Modeli i tregut të energjisë elektrike merr parasysh kërkesat e direktivave të BE-së për energjinë, si dhe çdo angazhim tjetër ndërkombëtar, të ndërmarrë nga vendi ynë.

3. Këshilli i Ministrave vlerëson propozimin e ERE-së dhe miraton modelin e tregut të energjisë elektrike.

Neni 54

Miratimi i rregullave të tregut

Pas miratimit nga Këshilli i Ministrave të modelit të tregut të energjisë elektrike, ERE-ja bashkëpunon me të gjithë pjesëmarrësit e sektorit të energjisë për diskutimin dhe miratimin e rregullave të tregut të energjisë elektrike, përfshirë rregullat që drejtojnë programimin, dispecerimin, ruajtjen e ekuilibrit dhe kërkesat e rezervës.

Neni 55

Tregu rajonal i energjisë elektrike

(Shtuar fjali në fund të pikës 1, shfuqizuar pika 2 me ligjin nr. 9913, datë 5.5.2008)

1. ERE-ja bashkëpunon me të gjithë pjesëmarrësit e sektorit të energjisë për të hartuar Kodin e Funkcionimit të Rrjetit, Kodin e Funkcionimit të Shpërndarjes, Kodin e Matjes, rregullat e interkonjeksionit që përputhen me standardet ndërkombëtare, si dhe kërkesat e një tregu rajonal, përfshirë protokollet e tranzitit, kërkesat e traktatit të kartës së energjisë dhe i miraton ato.

2. Shfuqizuar.

PJESA E SHTATË TË DREJTAT E PRONËSISË

Neni 56

Të drejtat e pronësisë së të licencuarit

1. Për sigurimin e shërbimit me energji elektrike, i licencuari mund të kërkojë përdorimin e njërës prej tagrave të pronësisë ose vetë të drejtën e pronësisë së të tretëve si më poshtë:

- a) të drejtën për linjat;
- b) të drejtën e përdorimit;
- c) të drejtën e servitutit;
- ç) shpronësimin.

2. Kur ushtrohen të drejtat, sipas pikës 1 të këtij neni, dëmet e shkaktuara nga:

- a) vendosja e shenjave, matjeve, testeve;
- b) instalimi i pajisjeve, aksesit në to si dhe kryerja e punës në to;
- c) pengimi ose kufizimi për përdorimin e pronësisë,

rimburohen nga i licencuari për pronarin ose përdoruesin e pasurisë, sipas Kodit Civil Titulli VI Kreu II dhe neneve 23 dhe 27-37 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”.

3. Në zonat natyrore të mbrojtura, të drejtat e përfshira në pikën 1 të këtij neni mund të jepen me miratimin paraprak të autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen e natyrës, në përputhje me ligjin nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”. Në zonat që gëzojnë mbrojtje lokale nevojitet miratimi paraprak i bashkisë ose komunës përkatëse.

4. Në rast të shuarjes së të drejtave, sipas pikës 1 të këtij neni, i licencuari rivendos gjendjen e mëparshme të pronësisë.

Neni 57

E drejta për linjat

1. Të licencuarit i jepet e drejta për linjat, për instalimin dhe funksionimin e rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes mbi pronën e të tretit, me kusht që kjo të mos pengojë përdorimin e pronës.

2. Për transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike në pronën e të tretit i licencuari kryen veprimet si më poshtë:

- a) instalon nën e mbi tokë linja elektrike dhe lidhje telekomunikacioni;
- b) instalon strukturat mbështetëse, pajisjet e transformimit dhe ato kyçëse të vendosura mbi to;
- c) shfrytëzon, mban, riparon, transformon dhe heq pajisjet e instaluar, sipas shkronjave

“a” dhe “b” të këtij neni;

ç) heq pemët, shkurret, degët e tyre dhe rrënjët e vendosura përgjatë linjave, që dëmtojnë zonën e sigurisë;

d) mund t’u afrohet dhe të kalojë në rrugët e transportit, të lumenjve, në rrjedhjet e ujërave, liqenet, kanalet dhe ndërtesat, sipas procedurave të parashikuara në rregulloret teknike dhe legjislacioni në fuqi.

Neni 58

E drejta e përdorimit

1. Pjesët e centralit të prodhimit të energjisë elektrike, pajisjet e sistemit të transmetimit, shpërndarjes dhe ato ndihmëse mund të vendosen, të përdoren dhe të mirëmbahen në pronën e të tretit, në bazë të të drejtës së përdorimit të përkohshëm.

2. E drejta e përdorimit të përkohshëm rregullohet sipas neneve 27-37 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”.

Neni 59

E drejta e servitutit

Në përputhje me dispozitat e Titullit VI Kreu II të Kodit Civil, i licencuari mund të kërkojë marrjen e të drejtës së servitutit për vendosjen e rrugëkalimeve të përkohshme, që përdoren për ndërtimin dhe shfrytëzimin e centraleve, nënstacioneve, linjave të transmetimit të energjisë elektrike dhe strukturave të tyre mbështetëse në pronën e personit të tretë.

Neni 60

Shpronësimi

1. Për ngritjen e centraleve, të nënstacioneve, të kabinave elektrike dhe të linjave të transmetimit të energjisë elektrike, i licencuari mund të nisë shpronësimin e pronës së një personi të tretë, në përputhje me nenin 8 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”.

2. Nisja e procedurës së shpronësimit për vendosjen dhe shfrytëzimin e rrjeteve të transmetimit e të shpërndarjes dhe të strukturave të tyre mbështetëse, mund të kërkohet vetëm nëse e drejta për linjat, sipas pikës 2 të nenit 57 të këtij ligji, pengon ose ndërpret përdorimin e rregullt të pronës.

3. Procedura e shpronësimit mund të fillojë për vendosjen dhe funksionimin e pajisjeve të transformimit dhe të kyçjes të vendosura jo mbi një strukturë mbështetëse, që i përket impiantit të energjisë elektrike, vetëm nëse palët nuk bien dakord për të drejtën e përdorimit, sipas nenit 58 të këtij ligji ose nëse autoritetet përgjegjëse të rregullimit të territorit nuk e kanë miratuar.

Neni 61

Të drejtat që lidhen me linjën e drejtpërdrejtë

Për ngritjen, mirëmbajtjen dhe përfundimin e të drejtave për vendosjen dhe shfrytëzimin e linjës së drejtpërdrejtë, zbatohen dispozitat e Kodit Civil që merren me kufizimin e pronësisë së të tretëve.

Neni 62
Zonat e sigurisë

1. Për mbrojtjen e centraleve, të nënstacioneve dhe të linjave të transmetimit të energjisë elektrike dhe mjedisit rrethues, përreth tyre përcaktohet një zonë sigurie.

2. Këshilli i Ministrave miraton me vendim shtrirjen e zonës së sigurisë dhe ndalimet e kufizimet që vendosen në këtë zonë.

3. Brenda zonës së sigurisë ndalohet ngritja e ndërtesave ose objekteve të tjera, mbjellja e bimëve, pemëve, si dhe kufizohet, në përputhje me rregullat e përcaktuara, kryerja e veprimtarive që mund të rrezikojnë sigurinë dhe funksionimin e centralit elektrik, nënstacioneve, linjave ajrore ose kablllore, jetën, shëndetin ose mbrojtjen e pronësisë.

PJESA E TETË
DISPOZITA TË TJERA

Neni 63
Kontrollet

ERE-ja, në përputhje me përgjegjësitë e përcaktuara në nenin 8 të këtij ligji, ka të drejtë të kontrollojë zbatimin e çdo fakti, kushti, praktike ose çështjeje të nevojshme ose të përshtatshme, për të përcaktuar nëse një person ka shkelur një nga dispozitat e këtij ligji, një rregull ose një urdhër që rrjedh nga ato.

Neni 64
Kundërvajtjet administrative
(Ndryshuar me ligjin nr. 10 485, datë 26.11.2011)

1. Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen nga ERE-ja me gjobë të barabartë me maksimumin e 3 për qind të të ardhurave vjetore të vitit paraardhës dhe minimumin 0,01 për qind:

a) Refuzimi i paraqitjes së të dhënave dhe raporteve periodike apo dërgimi me vonesë i tyre ose dërgimi i të dhënave të pasakta nga i licencuari.

b) Moszbatimi i detyrimeve që lidhen me llogaritjen e kostove e të tarifave, si dhe zbatimin e tyre.

c) Moszbatimi i detyrimeve të shërbimit publik, të vendosura sipas nenit 25 të këtij ligji.

ç) Moszbatimi i detyrimit për mbajtjen e llogarive të ndara, sipas neneve 23 dhe 33 të këtij ligji.

d) Moszbatimi i detyrimeve që lidhen me aksesin e palëve të treta në rrjet, siç përcaktohet nga dispozitat e këtij ligji dhe aktet e tjera nënligjore.

dh) Moszbatimi i detyrimeve të përcaktuara në kontratat e rregulluara.

e) Mospublikimi i informacionit për tarifën dhe kushtet e përgjithshme të aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të rrjetit.

ë) Mosparaqitja e planeve të investimeve, sipas kërkesave të nenit 24 të këtij ligji dhe rregullave përkatëse të ERE-së, si dhe moszbatimi i tyre.

f) Shkelja e një prej kushteve e standardeve të cilësisë së furnizimit, të miratuara nga ERE-ja.

g) Mospërbushja e urdhrave të ERE-së për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet të licencuarve nga ERE-ja.

gj) Shkeljet e kushteve të përcaktuara në licencë apo shkeljet e rregullave e të

rregulloreve të ERE-së, që nuk janë përcaktuar në shkronjat e mësipërme.

2. ERE-ja mund të vendosë gjobë progresive për çdo ditë shkeljeje nga i licencuari për rastet e mëposhtme:

a) Kur i licencuari nuk zbaton urdhrat e ERE-së për korrigjimin e një shkeljeje brenda afateve të përcaktuara nga ERE-ja, dënohet me gjobë në masën 0,5 për qind të xhiros mesatare ditore në vitin financiar paraardhës për çdo ditë shkeljeje nga dita e afatit të përcaktuar.

b) Kur i licencuari nuk përmbush detyrimet për pagesën e rregullimit ndaj ERE-së, për çdo ditë vonese nga dita e përcaktuar për pagesën përkatëse të rregullimit, dënohet me gjobë në masën 0,5 për qind të xhiros mesatare ditore në vitin financiar paraardhës.

3. ERE-ja miraton rregullat për përcaktimin me hollësi të vendosjes së gjobave e të lehtësimit prej tyre, duke marrë në konsideratë:

a) reduktimin në masën 50 për qind të gjobës, në rastet kur shkelja, për të cilën parashikohet gjobë, deklarohet nga i licencuari;

b) reduktimin në masën 1/3 e gjobës, kur i licencuari bashkëpunon në mënyrë efektive në procesin e investigimit të rregullatorit për shkeljen në fjalë;

c) reduktimin në masën 50 për qind, kur i licencuari demonstroi se ka bërë veprime që çojnë në përmirësimin e tregut të rregulluar.

4. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative, i ankimit dhe ekzekutimi i vendimeve të bordit bëhen sipas ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

Neni 65

Dispozitë kalimtare

Procedura për zgjedhjen e Bordit të ri të ERE-së fillon më 1 shtator 2003.

Neni 65/1

(Shtuar me ligjin nr. 9626, datë 16.10.2006; zëvendësuar fjalë me ligjin nr. 10 362, datë 16.12.2010)

Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, miraton rregullat dhe procedurat, sipas të cilave bëhen shkëmbimi, shitja dhe blerja e energjisë elektrike për shoqëritë publike që kryejnë këto veprime.

Dispozitë kalimtare

(E ligjit nr. 9512, datë 10.4.2006)

Ekipi përzgjedhës, brenda 2 javëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, verifikon përputhshmërinë e kriterëve të bordit të komisionerëve të ERE-së me kriteret e përcaktuara në këtë ligj dhe, nëse nuk plotësohen kriteret, i propozon Kuvendit lirim të tyre dhe emërimin në detyrë të personave, në përputhje me përcaktimet e nenit 4 të këtij ligji.

Dispozita kalimtare

(E ligjit nr. 10 362, datë 16.12.2010)

1. Kalimi i dokumentacionit të matjeve nga shpërndarësi te subjekti/organi i autorizuar duhet të fillojë me hyrjen në fuqi të këtij ligji dhe ky proces duhet të zgjasë jo më shumë se 6 muaj.

2. Në rast të tejkalimit të këtij afati, personi përgjegjës paguan dëmin e shkaktuar, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Deri në nxjerrjen e vendimit të Këshillit të Ministrave, inspektimi periodik do të

kryhet në përputhje me Kodin e Matjes.

Neni 66
Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 32, 36, 53 dhe 62 të këtij ligji.
2. Ngarkohet Enti Rregullator i Energjisë Elektrike të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 14, 20, 21, 24, 26, 44, 53, 54 dhe 55 të këtij ligji.

Neni 67
Shfuqizimi i ligjeve të tjera

Ligji nr.7962, datë 13.7.1995 “Për energjinë elektrike” dhe ligji nr.7970, datë 20.7.1995 “Për rregullimin e sektorit të energjisë elektrike”, shfuqizohen.

Neni 68
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3854, datë 20.6.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**